

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
AE GLOBAL SH.P.K.

\*\*\*

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë.

KREU I  
AKTI I THEMELIMIT - THEMELIMI, EMRI,  
OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

**Neni 1: Data e themelimit, emri dhe themeluesit**

1. Sot në Tiranë, Shqipëri, më datë 24.12.2021, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë me emrin **AE GLOBAL SH.P.K.**
2. Themeluesit e shoqërisë janë:
  1. Z. BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA, shtetas egjiptian, i lindur më datë 20.08.1988 në Ismailia, Egjipt, me pasaportë n. A27118347, e lëshuar nga zyra 42, Republika Arabe e Egjiptit;
  2. Z. AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, shtetas egjiptian, i lindur më datë 26.05.1981 në Ismailia, Egjipt, me pasaportë n. A18477203, e lëshuar nga zyra 42, Republika Arabe e Egjiptit.

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria ka si objekt ndërmjetësimin, tregtinë, me shumicë dhe pakicë, të produkteve të të gjitha llojeve si dhe import-eksport. Shoqëria mund të marr mandate, me dhe pa depozitë, si agjenci, përfaqësuese, agjenti i komisionit, koncesionari i firmës dhe kompanive me qëllime të ngjashme. Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj.

**Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar.

**Neni 4: Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga "Iljaz Reka", nd.19, kati 2, ap.3, Durrës, Shqipëri.
2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:  
[ahmedfoaad6@gmail.com](mailto:ahmedfoaad6@gmail.com)

REPUBLIC OF ALBANIA  
ACT OF ESTABLISHMENT AND STATUTE OF  
LIMITED LIABILITY COMPANY  
AE GLOBAL SH.P.K.

\*\*\*

In this Statute:

- "Law" is the Law no. 9901, dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies";
- "Statute" is the Statute of the company.

CHAPTER I  
ACT OF ESTABLISHMENT - FORMATION,  
NAME, OBJECT, DURATION AND LEGAL SEAT

**Article 1: Date of foundation, Name and Founders**

1. Today in Tirana, Albania, on 24.12.2021, we the founders, have founded a limited liability company with the name **AE GLOBAL SH.P.K.**
2. The founders of the company are:
  1. Mr. BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA, Egyptian citizen, born on 20.08.1988 in Ismailia, Egypt, with passport n. A27118347, issued by office 42, Arab Republic of Egypt;
  2. Mr. AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, Egyptian citizen, born on 26.05.1981 in Ismailia, Egypt, with passport n. A18477203, issued by office 42, Arab Republic of Egypt.

**Article 2: Object**

The object of the company is the intermediation, trade, wholesale and retail, of products of all kinds as well as import-export. The company can undertake mandates, with and without deposit, as agency, representative, commission agent, firm concessionaire and companies with similar purposes. The company can exercise any activity, which is not prohibited by law.

**Article 3: Duration**

The duration of the company is undetermined.

**Article 4: Legal Seat**

1. The legal seat of the company is at the address: Rruga "Iljaz Reka", nd.19, kati 2, ap.3, Durrës, Albania.
2. The address of the company for electronic communication purpose is as follows:  
[ahmedfoaad6@gmail.com](mailto:ahmedfoaad6@gmail.com)

احمد فواد

~ 1 ~

Bassam

**KREU II  
KAPITALI**

**Neni 5: Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues: BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Lekë që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 Lekë që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7: Transferimi i kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b. shitblerjes;
  - c. trashëgimisë;
  - d. dhurimit;
  - e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**CHAPTER II  
CAPITAL**

**Article 5: Basic Capital**

1. The initial basic capital of the company is 100.000 Albanian Lekë. The participation of the founders in the basic capital of the company is in accordance with their contributions as follows:
  - a) Founding Partner: BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA, owners of 1 (one) Share with the general value of 50.000 Albanian Lekë that constitutes 50 % of the basic capital of the company.
  - b) Founding Partner: AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, owners of 1 (one) Share with the general value of 50.000 Albanian Lekë that constitutes 50 % of the basic capital of the company.
2. The contribution of the partners may be in cash or in kind (movable property/immovable property or rights).

**Article 6: Increase and decrease of the Capital**

1. The capital of the company can be increased through the subscription of the parts of the basic capital for contribution in cash, and for the contribution in kind through the appointment from the competent court of an authorized expert for these contributions according to the requirements of the Administrator.
2. The majority cannot obligate, under any circumstances, a partner to increase his contribution in the basic capital of the company.
3. The decrease of the capital is allowed by the General Assembly, which will take the decision under the same conditions as for the amendment to the Statute.
4. In all case the decrease of the capital affects the partners to the same extent as their respective parts in the capital.

**Article 7: Transfer of Shares**

1. Shares and the rights they confer shall be acquired or transfer through:
  - a. Participation in the authorized share capital at the incorporation of the company;
  - b. Purchase;
  - c. Inheritance;

*mogri*

*Bass*

2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

#### Neni 8: Organi vendimmarrës

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të auditorëve ligjor;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. Shpërndarja e fitimeve vjetore;
  - i. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - j. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - k. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - m. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - n. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

- d. Donation;
- e. Other ways provided by the Law.
2. The parts of the basic capital are freely transferable between partners, unless otherwise provided in the Statute.
3. The parts of the basic capital are freely transferable through heritage.

### CHAPTER III DECISION-MAKING AND DIRECTING ORGANS

#### Article 8: Decision – Making Organ

1. The General Assembly of Partners is the only decision-making organ of the company.
2. The General Assembly of Partners is the only decision-making organ of the company that approves any amendments to the Statute according to the modalities foreseen by the Law.
3. The General Assembly shall decide on the following company matters:
  - a. Setting the business policies;
  - b. Amendments to the Statute;
  - c. Election and dismissal of the Administrators;
  - d. Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
  - e. Establishment of remunerations to persons mentioned under Numbers "c" and "d";
  - f. Monitoring and supervising the implementation of business policies by Managing Directors, including preparation of the annual statement of accounts and the performance report;
  - g. Adoption of the annual statement of accounts and performance reports;
  - h. Distribution of annual profits;
  - i. Increase and reduction of basic capital;
  - j. Dividing shares into parts and withdrawal of shares;
  - k. Representation of the company in court and in other proceedings against Managing Directors;
  - l. Company restructuring and dissolution;
  - m. Adoption of its own rules of procedure;
  - n. Other matters set by law or the Statute.

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*

4. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblësë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 9: Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblësë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10: Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
4. Mbledhja e asamblësë së ortakëve mund të zhvillohet gjithashtu në disa vende, audio dhe/ose video të lidhura, dhe kjo në kushtet e mëposhtme:

4. A partner may be represented at the General Assembly by another partner authorized by him or another authorized third party.
5. The Administrator of the company cannot act as a representative of another partner at the General Assembly Meeting.
6. The letter of authorization shall be issued for only one General Assembly Meeting including the reconvened meeting.

**Article 9: Method of Convening the General Assembly Meeting**

1. The General Assembly Meeting shall be convened by letter or by electronic mail. The letter or mail shall contain the place, date and hour of the meeting and be delivered together with the agenda to all members not later than 7 days before the scheduled date of the meeting.
2. Where the General Assembly Meeting has not been convened in conformity with Paragraph 1, the General Assembly Meeting may adopt decisions only if all the partners of the company agree to take decisions despite the irregularity.

**Article 10: Quorum**

1. In case of matters requiring ordinary majority, the General Assembly Meeting may only take valid decisions if attended by partners holding more than 30% of the subscribed voting shares.
2. In case of matters requiring qualified majority, as of Article 87, of the Law "On Entrepreneurs and Commercial Companies" the General Assembly Meeting may only take valid decisions if the partners having more than half of the total number of votes are participating in the voting in persona, by letter, or by electronic means in accordance with paragraph 3 of Article 88 of this Law.
3. If the General Assembly Meeting could not be held due to lack of the quorum referred to in Paragraph 1, the meeting shall be reconvened with the same proposed agenda within 30 days.
4. The meeting of the assembly of partners may also take place in several places, audio and/or video related, and this under the following conditions:
  - a. that the chairman and secretary of the meeting be present in the same place, who will arrange the

- a. që kryetari dhe sekretari i mbledhjes të jenë të pranishëm në të njëjtin vend, të cilët do të rregullojnë përgatitjen dhe nënshkrimin e procesverbalit;
  - b. që kryetari i mbledhjes lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
  - c. që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm për pikat në rendin e ditës.
5. Mbledhja e asamblesë do të konsiderohet e zhvilluar në vendin ku do të jetë i pranishëm kryetari.

#### Neni 11: Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
  - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c. emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesit ligjor;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve
  - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
3. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### Neni 12: Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

preparation and signing of the minutes;

- b. that the chairperson of the meeting is allowed to ascertain the identity and legitimacy of those present, to regulate the conduct of the meeting, to ascertain and announce the voting results;
  - c. to allow attendees to participate in simultaneous discussion and voting on agenda items.
5. The meeting of the assembly will be considered held in the place where the chairman will be present.

#### Article 11: Decision-Making


1. The General Assembly shall decide by three-quarter majority of votes of partners participating in the voting on the amendment to the Statute, the increase or decrease of the basic capital, profit distribution, company restructuring and dissolution
2. The General Assembly shall decide by majority of votes of participating partners for other issues such as:
  - a. Setting the business policies;
  - b. Election and dismissal of the Administrators;
  - c. Election and dismissal of independent auditors and liquidators;
  - d. Establishment of remunerations;
  - e. Monitoring and supervising the implementation of business policies by the Administrators including preparation of the annual statement of accounts and the performance report;
  - f. Representation of the company in court and in other proceedings against the Administrators;
  - g. Adoption of its own rules of procedure on convening the General Assembly Meeting.
3. Any amendment to the Statute must be submitted at the National Business Center in order to reflect the changes in the file of the company.

#### Article 12: Exclusion of Voting Right

1. A partner may not vote if the General Assembly decides on:
  - a. Assessing his performance;

- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 13: Administrimi


1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të shoqërisë:
  1. Z. AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, shtetas egjiptian, i lindur më datë 26.05.1981 në Ismailia, Egjipt, me pasaportë n. A18477203, e lëshuar nga zyra 42 Republika Arabe e Egjiptit. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.  
Nënshkrimi 
4. Asambleja e përgjithshme e ortakëve i jep administratorit autorizimin specifik të parashikuar në nenin 17, paragrafi 2, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 14 - Kompetencat e administratorëve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;


- b. Releasing from any of his obligations;
  - c. Any claim against him on behalf of the company;
  - d. Granting or not of any new benefit.
2. Where a partner is represented by a proxy, the proxy shall be deemed to be in the same position regarding conflicts of interest as the member he represents.

#### Article 13: Administration

1. The General Assembly shall nominate one or more natural persons as Administrators of the company for a term established by the Statute not exceeding 5 years, with the possibility of re-election. The nomination has legal effect once it is registered in the National Business Centre.
2. The Administrators of a parent company according to Article 207 of this Law may not be elected Administrators of a subsidiary and vice-versa. Any election made contrary to this provision is null and void.
3. The following persons are appointed as Administrator of the company:
  - a. Mr. AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI, Egyptian citizen, born on 26.05.1981 in Ismailia, Egypt, with passport n. A18477203, issued by office 42 Arab Republic of Egypt. The term of appointment is 5 years, with the right to re-election. Specimen of the signature 
4. The General Assembly gives to the administrator the specific authorization provided in article 17, paragraph 2, of law no. 9901, dated 14.4.2008 "On the entrepreneurs and Commercial Companies", as amended, of the Republic of Albania.

#### Article 14: Rights and obligations of the Administrators

1. The Administrators have the right and obligation to:
  - a. Manage the company's business by implementing the policies defined by the General Assembly"
  - b. Represent the company;
  - c. Ensure that the necessary accountancy books and documents are kept;
  - d. Provide for and sign the annual statement of accounts and





- d. përgatishin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:
    - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
    - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
    - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
  3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

- consolidated accounts and the performance report and present it to the General Assembly for approval together with the proposals for the distribution of profits;
- e. Create an early warning system with respect to developments threatening the existence of the company;
  - f. File for the registrations and submit the mandatory data of the company according to the Law on the National Business Center;
  - g. Report to the General Assembly with respect to the implementation of business policies and to the realization of transactions of particular importance for company performance;
  - h. Perform other duties set by law or the Statute.
2. The Administrators are obligated to convey the General Assembly in cases when:
    - a. according to the annual balance sheet or interim accounts reports result or exist the risk that the assets of the company will not cover up its liabilities within the next 3 months;
    - b. the company proposes to sell or otherwise dispose on the assets amounting to more than 5% of the company's assets resulting in the last certified financial statements;
    - c. the company, within the first 2 years after registration, proposes to purchase assets which belong to a partner and which amount to 5% of the company's assets resulting in the last certified financial statements.
  3. If the General Assembly appoints more than one administrator, they manage the company jointly.
  4. The General Assembly may dismiss the Administrator at any time by ordinary majority. Any claims, as for the compensation of the administrator, arising from any contractual relationship are governed by the legal provisions in force.

#### Article 15: Responsibilities of the Administrator

1. The Administrator is liable towards the Company or third parties for damages caused by breach of the laws, of the Statute, or for faults committed during the administration of the society.

### Neni 15: Përgjegjësite e administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
  2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
  3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:
    - a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
    - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
    - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
    - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
    - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
  4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
  6. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më
2. The consequences for any unapproved agreement from the Assembly, that brings damages to the company, are charged on the Administrator and the Partner that has made the agreement to face individually or jointly as the case maybe the respective consequences.
  3. Apart from what is provided in the general provisions on the fiduciary duty, according to articles 14, 15 and 18 of the Law "On the Entrepreneurs and Commercial Companies, the administrator is obliging to:
    - a. Perform his duties established by the law and the Statute in good faith in the best interests of the company as a whole which includes the environmental sustainability of its operations;
    - b. Exercise powers granted to him by the law and the Statute only for the purposes established therein;
    - c. Give adequate consideration to matters to be decided;
    - d. Avoid actual and potential conflicts between personal interests and those of the company;
    - e. Perform his duties with professionalism and reasonable care.
  4. The Administrator during the performance of his duties, is held liable for any action or failure to act reasonably related with the purpose of the commercial company, unless the action or omission was made in good faith, based upon reasonable inquiry and information, and rationally related to the purposes of the company.
  5. In case when the Administrator acts in violation of his duties and infringes the professional standards according to points 1 and 2 of this Article, he is obliged to compensate the company for any damage which occurred due to the violation, as well as to disgorge any personal profits made by him or the person connected with him, in violation of his duties to the company.
  6. The Administrator has the burden of proving compliance with the duties and standards. In case the violation has been committed by more than one of the Administrator, they are jointly and severally liable towards the company.



- shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
7. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
  - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - jep kredi.

#### KREU IV VITI FINANCIAR

##### Neni 16: Viti financiar

- Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.
- Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 dhjetor.

##### Neni 17: Auditimi ligjor

- Audituesi ligjor ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- Në përfundim të kontrollit audituesi ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohe ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

7. In particular, but not limited to these, the Administrator is obliged to compensate the company for damages caused, if in violation of the provisions of the Law "On the Entrepreneurs and Commercial Companies, carries out the following transactions contrary to this Law:
- Returns to the partners the contributions
  - Pays interests or dividends to the partners
  - Distributes the company's assets;
  - Allows the company to continue to do business when based on the financial status, should have been foreseen that it will not be able to pay its debts;
  - Grants loans.

#### CHAPTER IV FINANCIAL YEAR

##### Article 16: Financial Year

- The financial year commences on January 1st and ends on December 31st, of each calendar year.
- Except for the first financial year, that commences from the date of registration of the company in the National Business Center, and is closed on December 31st.

##### Article 17: Legal audit

- The legal auditor has the obligation to control the entire accounting documentations of the economic activity of the commercial company, the annual and the periodic control performed from him in cases when he has been appointed and has performed such duty charged by the partners
- At the end of the control, the legal auditor prepares the report, in writing, for issuing the results of the annual balance sheet, as well as the report for the periodical controls, which is obliged to present and submit in time to the partners for deliberation and approval based on their right to vote.

**KREU V  
PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18: Prishja dhe likuidimi**

1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
  - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b. me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - e. me vendim të gjykatës.
2. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "*Shoqëri në likuidim e siper*".
3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.
5. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX-të të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 20: Baza ligjore**

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo

**CHAPTER V  
DISSOLUTION – RESTRUCTURING OF THE  
COMPANY**

**Article 18: Dissolution and Liquidation**

1. The Company can be dissolved at any time, under the following circumstances:
  - a. By expiry of the period for which it was established;
  - b. By decision of the General Assembly;
  - c. By opening of the bankruptcy procedures;
  - d. If it has not carried out any business activities for two years and has not notified its inactive status in accordance with paragraph 3 of Art. 43 of Law No. 9723 "On the National Registration Centre";
  - e. By court decision.
2. In this case the Partners take the decision, in writing, in which foresee the method of liquidation of the company by appointing one or more liquidators, and any documents issued by the company should have the name of the liquidators and the additional nomination "*Company in liquidation*".
3. The dissolution of the commercial company has as a consequence the initiation of the liquidation procedures in the state of solvency, unless it has initiated the bankruptcy procedure.
4. The liquidation is carried out by the liquidators on behalf of the Partners.
5. When the partners do not take a decision upon the appointment of the liquidators within 30 days after the dissolution, any interested person can address the court to appoint a liquidator.

**Article 19: Restructuring the company Merger-Division**

1. The company can be divided, merged based on the Decision of the General Assembly of the Partners according to the legal provisions foreseen in Part IX of the Law no. 9901, dated 14.04.2012 "On the entrepreneurs and Commercial Companies"

**Article 20: Legal Basis**

1. The company will carry out its activity in conformity with this Statute and the legal provisions of the Albanian Legislation.

ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21: Mosmarrëveshjet**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**AE GLOBAL SH.P.K.**

BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA

*Bassam Taha*  
*Bassam*

AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUMI

*Ahmed Fouad ABDELhamid Bayoumi*

*أحمد فؤاد*

Emer mbiemer  
(nenshkrimi)

2. Unless otherwise provided in this Statute, shall apply the provisions of the Law "On the entrepreneurs and Commercial Companies", Civil Code and any other specific law of the Republic of Albania.

**Article 21: Disputes**

1. Any dispute arising out of or related with the implementation or interpretation of this Statute, as well as any dispute between the Company and third parties, shall be referred to the Albanian Court, the District Court of Tirana.

**PARTNERS**  
**LIMITED LIABILITY COMPANY**  
**AE GLOBAL SH.P.K.**

BASSAM TAHA MAHMOUD TAHA

*Bassam Taha*  
*Bassam*

AHMED FOUAD ABDELHAMID BAYOUM

Name Surname  
(signature)